

VENDIM
Nr. 167, datë 17.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 407, DATË 8.5.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NJË REGJIMI
KONTROLLI PËR TË GARANTUAR RESPEKTIMIN E RREGULLAVE TË
POLITIKAVE MENAXHUESE NË PESHKIM”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 72, pika 8, 74, pika 3, 82, pika 2, 101, pikat 2 e 3, 113, pika 1, 116, 118, pika 3, dhe 135, pika 1, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 33 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“33. Të gjitha anijet mbi 12 m, të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit (RAP), instalojnë në bordin e tyre pajisjen MTU (*Mobile Tranceiver Unit*), për identifikimin e lokalizimin nëpërmjet satelitit. Kjo pajisje duhet të jetë në përputhje me sistemin e instaluar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe në ministri, si dhe duhet të plotësojë të gjitha specifikimet, sipas pikës 24, të këtij vendimi.

Ministria përgjegjëse për peshkimin u jep në përdorim të gjitha anijeve mbi 12 metra, të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit, pajisjen MTU, e cila, nëse del jashtë funksionimit, zëvendësohet me shpenzimet e subjektit përdorues.”.

b) Pika 33/1 shfuqizohet.

2. Fondet për blerjen e pajisjeve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, për vitin 2021, të përballohen nga buxheti i shtetit i këtij viti, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe